



KUVEND MBARËKOMBËTAR

KONGRESI I LUSHNJES – THEMELET E SHTETIT TË SOTËM SHQIPTAR

Përpjekjet e shqiptarëve pas pavarësisë deri në Kongresin e Lushnjes për të formuar bazat e shtetit të sotëm shqiptar

KARTA E BARDHË E KUVENDIT

(REZOLUTË)

Shoqatat organizatore:

Në marrëveshje
me:

"ILIRICUM SACRUM"

Bashkinë Lushnje

FORUMI "IMAZH & MEDIA"

Bashkinë Fier

UNIONI SHQIPTAR I SHOQËRISË CIVILE

Bashkinë Vlorë

ALEANCA QYTETARE PËR MBROJTJEN E VLERAVE
KOMBËTARE"

Bashkinë Berat

SHOQATA "PAL ENGJËLLI"

Universitetin e Tiranës,

FORUMI I MBROJTJES SË TRASHËGIMISË HISTORIKE
KULTURORE "NIKAJ MËRTUR"

Universitetin Aleksadër Xhuvani", Elbasan

LIDHJA E HISTORIANËVE TË KOSOVËS

Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë

"ALIHADRI"

SHOQATA "MENV GROUP"

Universitetin European të Tiranës, Tiranë

QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE- G & G GROUP

"

Lushnje, 28 Janar, 2020

Kongresi i Lushnjes ose Mbledhja Kombiare e burrave shqiptarë, më datat 21–31 Janar 1920, 100 vjet më parë, në kushtet kur:

1. Shteti shqiptar nuk ekzistonte;
2. Vendi dhe trualli shqiptar ishte ende në copëtim e robërime të reja;
3. Kufijtë territorialë, megjithëse të cunuar edhe më nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër ishin ende të pasigurt;
4. Njohja ndërkombëtare ishte ende në letra dhe nëpër analet e diplomacive të fuqive të mëdha;
5. Konferenca e Parisit, iden, si ajo e Londrës vazhdonte ta mbante të gozhduar Shqipërinë, me status nënkujdes të fuqive të tjera europiane (Francë, Itali, Angli);



arritën dhe hodhën themelet e Shtetit të sotëm Shqiptar, për faktin se:

1. i dhanë fund anarkisë, si asaj ndërkombëtare dhe asaj brenda vendit për konceptin e filozofizë së ndërtimit të shtetit nga vetë shqiptarët;
2. i treguan botës dhe Europës, se shqiptarët dinë të ndërtojnë shtet të pavarur, të pandashëm, dhe të gatshëm për t'iu përveshur punës për të bërë shtet.
3. e pajisën këtë vend me administratën e parë të shtetit shqiptar, megjithëse arka e tij nuk kishte një ovull (qindarkë) brenda saj;
4. e pajisën këtë vend për herë të parë, pas 500 vjetësh, me gjuhën e parë zyrtare, si atë shqip, me vulën dhe filatelinë përkatëse.
5. e pajisën këtë vend, me shkollat e para zyrtare shqiptare në çdo cep të Shqipërisë, (kujtojmë shkollën bujqësore me 60 nxënës në Lushnje);

6. organizuan dhe mbajtën Kongresin e parë Arsimor shqiptar, si gur themeli për rritjen e ndërgjegjes kombëtare.
7. përcaktuan me llogjikën më të lartë të kumtit të mendimit – Kryeqytetin shqiptar, si vend kryeqendër e Ar(l)banisë, dhe si vend, ku ruhen dhe përplasen ekuilibrat natyrorë e shoqërorë.
8. e çuan këtë vend drejt çlirimit dhe marrjes së qyteteve, si Shkodër më 25 Mars 1920, rimarrjes së qytetit të Gjirokastrës me zonat përreth, më 27 Prill 1920, dorëzimit të Korcës prej Francezëve më 15 maj 1920 dhe lirimit të Vlorës prej kolonizatorëve të rinj, si ata Italianë në gusht 1920, me luftën titanike të trimave lebër Tepelenë – Vlorë;
9. krijuan xhandarmërinë e parë shqiptare që menjëherë i dha vendit qetësinë dhe sigurinë e vetqeverimit, aq sa 260 myzeqarë trima me komandant Zoi Ndrekon iu gjendën si mbrojtës ëngjëllorë Kongresit të Lushnjës, dhe bënë që të tutesh milicia italiane 260m më tej;
10. krijuan Parlamentin e parë Shqiptar dhe i dhanë formë Regjimit të Shtetit Shqiptar, si një Republikë midis republikave të tjera europiane dhe shteteve fqinj përreth.
11. formuluan ‘Strategjinë e Shtetit Shqiptar’ sipas trinomit “mbijetesë – burimet e kombit dhe mënyrat e përfitimit prej kërtyre aseteve”;
12. së fundi, e çuan këtë vend drejt njohjes përfundimtare të sovranitetit të shtetit shqiptar, duke e futur në Lidhjen e Kombeve, më shtator 1920 deri sa u njoh më 17 dhjetor, si antar me të drejta të plota në të.



Duke bërë kështu që Kongresi i Lushnjes të jetë shumë më i madh se Lushnja, madje shumë më i madh se Shqipëria, dhe një nga vlerat më të mëdha të Kombit Shqiptar, e krahasueshme me Kuvendin e Lezhës 1444, me Lidhjen e Prizrenit më 1878, dhe po aq me Kuvendin e Mëvetësisë, 28 Nantuer 1912.



Për sa më sipër, do të donim fort që Shteti i sotëm shqiptar të trajtojë me konsideratën më të lartë kërkesat që dolën në këtë Kuvend Mbarëkombëtar dhe me anë të kësaj Rezolutive iu drejtohem i juve si personave kyç të vendit që:

1. Të shpallet data 21 Janar, si një festë kalenderike e një rëndësie mbarëkombëtare, ku të gjithë shqiptarët në katër shtetet, ku ata bëjnë sot pjesë të kenë mundësinë e gëzimit dhe të përkujtimit, si dita e parë e shtetit të sotëm shqiptar, po aq, edhe si një dite e madhe kombiare në kurorëzim e plotësim të Ditës së Pavarsisë.
2. Të ngrihet një monument i Kongresit me të gjithë emrat e pjesmarrësve në Lushnje e në Tiranë dhe me ngjarjet që lidhen me atë.
3. Nën kujdesin e shtetit shqiptar, shtëpia ku u mbajt Mbledhja kombiare – Kongresi i Lushnjes, të futet në rradhët e monumenteve të kulturës dhe të ruhet si muze e aset kombëtar.
4. Nën kujdesin e shtetit shqiptar, të hartohet një libër studimor e voluminoz në nivel akademik, me të gjitha të thënat dhe të pathënat për Kongresin e Lushnjes.
5. Viti 2020 të quhej viti i Kongresit, për faktin se nuk ka asnjë vit në historinë e shtetit të ketë kaq shumë ngjarje të mëdha dhe të ketë qenë kaq i mbarë si ndërtimi i shtetit (qeveri, parlament,

- Tirana–kryeqytet, etj); në bashkimin e shtetit (Shkodra, Korça, Gjirokastra e Vlora), në mbijetesën e shtetit (diplomaci deri në njohjen ndërkombëtare–anëtarimin në Lidhjen e Kombeve, etj).
6. Në çdo vit, një mbledhje e Parlamentit apo edhe e Qeverisë në periudhën (21–31 Janar) të mbahet në Shtëpine e Kongresit në Lushnje për të kujtuar që Shqipëria shpëtoi dhe rrojti nga ky Kongres.



PËR AKADEMINË ALTERNATIVE SHKENCORE RRËNJËT TONA

DREJTOR EKZEKUTIV

Prof.Ing. Av. Sazan **GURI**

KRYETAR I KOMITETIT SHKENCOR

Fatbardha **DEMI**

DREJTOR I BORDIT

Dr.Ing. Stefan **PINGULI**

KRYETAR I KOMITETIT ORGANIZATIV

Ing.Dipl. Fred **BALAJ**